



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:051413

Datë: 05.03.2025

Numri i dokumentit: 06942835

KA.nr.834/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Restaurant Ana Petrol”, me seli në Podujevë, kundër të paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë AUV, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit AUV.04/2-103/2021 të datës 09.02.2021, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit kryesor publik me datë 18.02.2025, konform nenit 41 të LKA-së në mungesë të përfaqësuesit me autorizim të paditësit dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, më datë 27.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Restaurant “Ana Petrol”, me seli në Podujevë, kundër të paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë –AUV, me seli në Prishtinë,
- II. **ANULOHET** si i kundërligjshëm vendimi i së paditurës Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të AUV-së, AUV.04/2-103/2021 të datës 09.02.2021, ndërsa çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje
- III. **OBLIGOHET** e paditura Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë – Komisionit për Vendosje që në afat prej tridhjetë (30) ditësh në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 18.03.2021, në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative, paditësi Restaurant Ana Petrol, me seli në Podujevë ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A-612/21, kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), me seli në Prishtinë, me propozim që Gjykata të aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, të anulohet vendimi i të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë me nr. AUV.04/2-103/2021 të datës 09.02.2021, ndërsa çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 834/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik më datë 19.02.2025, konform nenit 41 të LKA-së, në mungesë të përfaqësuesit të paditësit - për seancë është deklaruar ne parashtrëse të datës 19.02.2025 dhe në mungesë të palës së paditur nga avokatura shtetërore - për seancë është deklaruar ne parashtrëse të datës 14.02.2025.

Pretendimet e palës paditëse

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi, si dhe parashtrësës së datës 19.02.2025 ka deklaruar se përmes vendimit të kundërshtuar me padi AUV.04/2-103/2021 të datës 09.02.2021 i nxjerr nga e paditura, i njëjti përmban një arsyetim absurd në atë se ankesa e palës është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor, në kundërshtim me nenin 81 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA-së), më konkretisht nenit 81 i cili përcakton se *“kur afati përcaktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja nga e cila fillon të ecë afati”*, ndërsa në rastin konkret ngjarja ka ndodhur më datë 14.01.2021 e që afati fillon të ecë pas datës 14.01.2021 që vetvetiu nënkupton se fillon të ecë më datë 15.01.2021, andaj ankesa e

palës është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor i cili ka qenë i përcaktuar të jetë 8 ditë.

5. Ka shtuar se gjatë kontrolleve të realizuara nga Trupat e Inspektoratit Sanitar, klientët disa ishin duke dalë e disa i paguar shërbimet e ofruara nga restoranti, shumica e karrigeve ishin të vendosura mbi tavolina, që nënkupton se kishte përfunduar orari i punës, mirëpo ndonjëherë ndodh që dhe duhet 10-15 minuta kohë për ta bindur një klient të liroj sallën, ndërsa inspektorati nuk e pati parasysh fare këtë situatë dhe as vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 01/51 të datës 22.12.2020, në të cilën është përcaktuar në nenin 38 par. 5 se shërbimet e hotelerisë dhe gastronomisë lejohet të punojnë nga ora 05:00 deri në orën 20:00, ndërsa pas orës 20:00, punojnë porosi me dërgesë. Në parashtrësën e datës 19.02.2025 ka deklaruar se duke u bazuar në Ligjin për kundërvajtje administrative, rasti konkret është i parashkruar. Gjykatës i ka propozuar që të aprovet në tërësi si e bazuar kërkesëpadinë e paditësit, të anulohet vendimi i të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë –AUV me nr. AUV.04/2-103/2021 të datës 09.02.2021, ndërsa çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, ose të pezullohet procedura e kundërvajtjes ndaj subjektit Ana Petroll SH.P.K. për shkak të parashkrimit absolut të kundërvajtjes.

Kundërshtimet e palës së paditur

6. Përfaqësuesja e të paditurës në pretendimet e dhëna përmes përgjigjes në padi, sipas parashtrësës së datës 14.02.2025 ka deklaruar se e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, pasi që vendimi është marr konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe ajo të cilën e pretendon pala nuk qëndron, pasi që ky vendim është marr konform legjislacionit në fuqi. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, ndërsa vendimi i së paditurës AUV.04/2-103/2021 të datës 09.02.2021, të mbetet në fuqi.

Provat e administruara

7. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim i me nr. AUV.Ref.04/2-103/2021 i datës 09.02.2021, Njoftim lidhur me kundërshtimin e parashtruar ndaj vendimit me nr. AUV Ref. 04/2-103/2021, i datës 26.02.2021, Flet përmbajtje për kundërvajtje lëshuar nga Inspektorati Sanitar i Kosovës

me nr. 001430/IS i datës 14.01.2021, Ankesë e datës 22.01.2021, ndaj fletëparaqitjes për kundërvajtje me nr. 001430 e datës 14.01.2021, Procesverbal mbi inspektim me nr. 005649 i datës 09.01.2021, Procesverbal për inspektim me nr. 005818 i datës 08.12.2020. Nga provat e administruara gjykata vlerësoj:

8. Nga fletë përmbajtje për kundërvajtje lëshuar nga Inspektorati Sanitar i Kosovës me nr. 001430/IS i datës 14.01.2021, Inspektorati Sanitar i Kosovës në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë-AUV më datë 14.01.2021, ka inspektuar lokalin në ora 20:30, ka konstatuar se lokali në fjalë ka pasur klient edhe pas orës 20:00 duke vepruar në kundërshtim me vendimin 01/51 të datës 22.12.2020 më konkretisht pika 37.3 sipas të cilës hotelëritë dhe gastronomitë lejohen të punojnë nga ora 05:00 deri në ora 20:00, duke i shqiptuar gjobë. Afati për paraqitje të ankesë është 8 dite.
9. Pala tani paditësi ka parashtruar ankesë më datë 22.01.2021, ndaj fletëparaqitjes për kundërvajtje me nr. 001430 e datës 14.01.2021.
10. Nga Vendim me nr. AUV.Ref.04/2-103/2021 i datës 09.02.2021, i lëshuar nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të AUV-së, është hedhur si e pas afatshme ankesa me nr. 356 e datës 22.01.2021, me arsyetim se palës gjoba i është shqiptuar më datë 14.01.2021 dhe afati për paraqitjen e ankesës ka qenë brenda 8 ditësh, sipas nenit 60 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, ndërsa ankesa është dorëzuar më datë 22.01.2021, tek e paditura AUV, me vonesë, ku si provë është vula zyrtare e AUV-së e cila tregon se kjo ankesë është e pranuar më datë 22.01.2021.

Vlerësimi i gjykatës

11. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.
12. Lidhur me këtë, gjykata konstaton se çështje kontestuese në këtë konflikt administrativ në mes të palëve është afatshmëria e ankesës të ushtruar nga paditësi ndaj Flet

përmbajtjes për kundërvajtje, lëshuar nga Inspektorati Sanitar i Kosovës me nr. 001430/IS i datës 14.01.2021. Gjykata vlerësoi si të bazuara pretendimet e paditësit, sepse të njëjtat janë në përputhje me provat e administruara në këtë çështje si dhe kanë mbështetje në dispozitat materiale që rregullojnë këtë çështje.

13. Ligji Nr. 05/L -031 i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në nenin 81 përcakton llogaritjen e afateve, ku në paragrafin paragrafi 1 parasheh se *“Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, afatet do të përcaktohen në ditë, muaj apo vite. Mbarimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike, paragrafi 2 parasheh se “Kur afati përcaktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja nga e cila fillon të ecën afati”*, lidhur me nenin 125 ku është përcaktuar se 1. *Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”). 2. Një veprim procedural i një organi publik gjatë procedurës administrative, mund të ankimohet ndaras, vetëm kur kjo parashihet shprehimisht me ligj.*
14. E paditura në vendimin e kundërshtuar me padi gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike kur e ka hedhur si të pas afatshme ankesën me nr. 356 të datës 22.01.2021 të palës tani paditësit, pasi që flete përmbajtja për kundërvajtje i është shqiptuar më datë 14.01.2021, pra afati për ankesë ka filluar rrjedh nga data 15.01.2021, ndërsa paditësi e ka parashtruar ankesën në ditën e tetë, pra më datë 22.01.2021, brenda afatit të paraparë ligjorë, ashtu siç përcaktohet me dispozita ligjore.
15. Andaj në rivendosje e paditura është e detyruar që konstatoj saktë gjendjen faktike, të shqyrtoj të gjitha pretendimet e palës tani paditësit të cilat i ka parashtruar në ankesë me nr. 356 të datës 22.01.2021 dhe të vlerësoj meritorisht në mënyrë të drejtë gjendjen faktike bazuar në prova sa i përket gjobës së shqiptuar përmes Flete përmbajtjes për kundërvajtje, lëshuar nga Inspektorati Sanitar i Kosovës me nr. 001430/IS i datës 14.01.2021.
16. Vendimin i kundërshtuar i AUV.04/2-103/2021 të datës 09.02.2021 Është marrë në kundërshtim me Nenin 16 1. Të LKA-së ku përcaktohet *Akti administrativ përfundimtar mund të kundërshtohet: 1.1. për shkak se nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar*

drejt dispozitat ligjore; 1.2 . për shkak se akti është nxjerrë nga organi jo kompetent; 1.3. për shkak se në procedurë, që i ka paraprirë aktit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike, apo nëse nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike;

17. Prandaj konform Neni 43 1. Të LKA-së ku përcaktohet *Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative. 2. Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*
18. Gjykata nuk u lëshua në shqyrtimin e te gjeturave/konstatimeve në flete përmbajtje për kundërvajtje pasi që këtë duhet ta vlerësoj se paditura sipas ankesës së palës tani paditësit në rishqyrtim dhe rivendosje. Sipas Nenit 44 1. Të LKA-së Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë.
19. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi për shpenzimet procedurale u more në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.834/22, datë 27.02.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.